

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2  
23.07.xxxx

NR. VENDIMI 4  
16.05.2011

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

**GJYQTAR: KLODIAN KURUSHI**  
**GJYQTARE: ANTONELA PRENDI**  
**GJYQTAR: SHKËLQIM MUSTAFA**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Evlonda Adili** sot më datë 16. 05. 2011 mori në shqyrtim çështjen gjyqësore me palë në proces:

**KËRKUES :** Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **A. XH. .**

**OBJEKTI:** Konfiskim i pasurive të sekuestruara me vendimin gjyqësor nr. 04 datë 25. 02. 2010 të gjykatës së shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë.

**Personi ndaj të cilit**  
**kërkohet konfiskimi**  
**i pasurive.**

**A. H. ,** i biri i Sh. dhe i M. , i dtl  
xx .xx. xxxx, lindur dhe banues në xxxxxx, i  
cili aktualisht ndodhet i paraburgosur, në  
ambientet e  
Institucionit te Paraburgimit, Rr.”Jordan Misja”,  
Tirane akuzuar për veprat penale të “*Vrasjes me*  
*paramendim*” te shtetasit Xh. D. , e

*parashikuar*

si krim nga neni 78 i Kodit Penal, “Mbajtjes pa leje te armes luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, “Organizates kriminale” dhe te “Kryerjes te vepres penale nga organizata kriminale”, parashikuar nga nenet 333 e 334 te K.Penal përfaqësuar në gjykim mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**

**PERSONA TË TRETË:**

1. **G. H.**, i biri i Sh. dhe i M. , i dtl xx.xx.xxxx, lindur dhe banues ne Lagja “xxxx xxxxx”-xxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
2. **T. H.** , i biri i Sh. dhe i M. , i dtl xx.xx.xxxx, lindur dhe banues ne Lagja “xxxx xxxxx”-xxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
3. **M. H** , e bija e B. dhe Q. e dtl. xx. xx. xxxx lindur dhe banuese në xxxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
4. **A. H.**, i biri i Sh dhe i M lindur dhe banues në xxxxxxxxxx, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
5. **L. H (N.)**, e bija e Sh. dhe e M. e dtl. xx. 02. 1963  
lindur  
dhe banuese në xxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
6. **A. H. (V)**, e bija e Sh. dhe e M. e dtl. xx. xx. xxxx lindur dhe banues në xxxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**
7. **E. H. (Sh.)**, e bija e Sh.t dhe e M. e dtl. xx. xx. xxxx  
lindur

dhe banuese në xxxxxxxx përfaqësuar me prokurë

të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe

**A. B. .**

**8. E. H.,** e bija e Th. dhe e M., e dtl. xx. xx. xxxx lindur dhe banuese në xxxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**

**9. D. H.,** e dtl. xx. xx. xxxx lindur në xxxx dhe banuese në xxxxxxxx përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**

**10. O. Sh.,** i biri i B. dhe i L. i

Dtl. xx. xx. xxxx lindur dhe banues në Lushnje përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**

**11. K. Sh.,** e bija e J. dhe e R. e dtl. xx. xx. xxxx lindur dhe banuese në xxxxxxxx

përfaqësuar me prokurë të posaçme nga mbrojtësit **S. D.** dhe **A. B. .**

**12. S. G ,** i biri i I. dhe i E.

i

Dtl. xx. xx. xxxx lindur në xxxx dhe banues në xxxxxx i pranishëm në seancë gjyqësore.

**13. M. G ,** e bija e S. dhe e D. e dtl. xx. xx. xxxx lindur në xxxxxxxx dhe banuese në xxxxxxxx e pranishme në seancë gjyqësore.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të seancës gjyqësore palët në proces kërkuan:

**Prokuroria:** Konfiskimin e pasurive si më poshtë:

**Një garazh,** i cili ndodhet në kryqëzimin e rrugëve “xxxx xxxxx” dhe

“xxxxx xxxx”, Tiranë.

**Pasurisë me sipërfaqe totale xxx mx truall**, me vendodhje Zona Kadastrale nr. xxxx, nr. i Pasurisë x/xxx, fleta nr. xxx indeksi, lagja “xxxxxx xxxxxxxx” - xxxxxxx.

**Motorçikletë xxxxxxxx**, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, prodhim i vitit xxxxx, me targa **xx xxx x**, në pronësi të të pandehurit **A. Sh. H.**, e blerë në datë xx/xx/xxxx, sipas kontratës me nr. xxxx Rep.

**Automjetit tip Autoveture, Marka xxxxxxxx-xxxxxx**, prodhim i vitit xxxxx, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, me targa **xx xx xx x** në pronësi të të pandehurit **A. Sh. H.**

**Mjetit KAMION, marka xxxxxx** me nr. Shasie xxxxx, prodhim i vitit xxxxx, me targa **xx xx xx x**.

**Mjeti AUTOVETURE, marka xxxxx**, me nr. Shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, prodhim i vitit xxxxx, me targa **xx xx xx x**.

**Llogarisë bankare pranë BKT – Lushnje, me nr. xx xx xx xxx**, e çelur në emër të të pandehurit A. Sh. H. , në shumën **1, 148. 81 Euro**,

Heqjen dorë nga e drejta e padisë, rrëzimin pjesërisht të kërkesës dhe heqjen e sekuestros për pasuritë e mëposhtme:

**Truall + ndërtesë, me sipërfaqje totale xxx mx**, e regjistruar me nr. x/xxx, Vol xx, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, lagja “xxxx xxxxx”-xxxxxx. Ky objekt, sipas kontrates se shitblerjes me nr. xxxx Rep dhe xxx Kol, date xx/xx/xxxx, ka kaluar në bashkëpronësi të të pandehurit **A. Sh. H.** dhe vëllait të tij **G. Sh. H.**

**Apartament banimi “A”, me sipërfaqe xxx.xx mx**, kati i shtatë, i përbërë nga tre dhoma një guzhinë, dy banjo, korridor, dy ballkone si dhe regjistruar në pasurine me nr. x/xxx, zona kadastrale nr. xxxx, Regjistri xxx.

**Personat e tretë kërkuan:**

Rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për konfiskimin e pasurive.

Gjykata pasi administroi provat e shqyrtuara këtë gjykim, si dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi

## V Ë R E N

Në datën 01. 11. 2009, Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka regjistruar procedimin pasuror ndaj shtetasit A. H. etj. Regjistrimi i procedimit pasuror ka ardhur si rezultat i hetimit dhe më pas gjykimit që i është bërë të pandehurit A. H. akuzuar për veprat penale si më poshtë:

*“Vrasjes me paramendim” të shtetasit Xh. D. , parashikuar si krim nga neni 78 i Kodit Penal;*

*“Mbajtjes pa leje të armës luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.*

*“Organizatës kriminale” dhe te “Kryerjes të veprës penale nga organizata kriminale”, parashikuar nga nenet 333 e 334 te K. Penal.*

Në datën 17. 04. 2007, Prokuroria per Krime te Renda-2007, ka dërguar për gjykim çështjen në ngarkim të të pandehurit A. H. dhe të 7 të pandehurve të tjerë dhe aktualisht kjo çështje është ende në fazën e gjykimit ku i pandehuri **A. Sh. H.** , po gjykohej për veprat penale për të cilat dhe është akuzuar.

**Më datë 03. 08. 1997 në qytetin e Lushnjës, është vrarë me armë zjarri shtetasi shqiptaro-maqedonas Xh. D.** Në hyrje të qytetit te Lushnjes viktimat së bashku me familjarë të tij janë ndaluar nga katër persona të armatosur, ku ndërmjet tyre dyshohej se kanë qenë të pandehurit A. H. dhe I. S. Pasi kanë vënë maskat në kokë ata kanë qëlluar në drejtim të shtetasit Xh. D. , i cili kishte zbritur nga furgoni, duke i shkaktuar atij vdekjen. Ndërkohe i pandehuri A. B. , i cili ka qenë në një autoveturë afër vendit të ngjarjes është afruar me shpejtësi dhe në autoveturë kanë hyrur të gjithë personat e sipërcituar.

Të gjithë viktimat për të cilët është akuzuar i pandehuri A. H. dhe të pandehurit e tjerë, kanë qenë shokë, miq të shtetasit të vrarë A. D. , i cili ishte kundërshtari i personit që dyshohet si drejtues i organizates kriminale A. B.

Si moment i krjimit të organizates, e ashtequajtura “Bande e Lushnjes” apo “Grupi i A. Sh.” është vrasja dhe dhunimi i kufomës të shtetasit R. Sh., vëllai i të pandehurit A. B., në muajin Korrik të vitit 1997 në qytetin e Lushnjes. Kjo vrasje dyshohet se ka ardhur si pasojë e përballjes me bandën e shtetasit A. D., banor i qytetit të Lushnjes. Pas vrasjes shtetasi A. B., me qëllim hakmarrjen ndaj shtetasit A. D. dhe pjestarëve të bandës, krijoi bandën e tij.

Sa parashtruam më sipër, rezulton se i pandehuri A. H. , është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, (neni 3/1 germa “a”). Prokuroria “Për Krimet e Rënda” Tiranë ka filluar hetimin pasuror për pasuritë e fituara nga i pandehuri A. H. si dhe të afërmit e tij.

Gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me vendimin nr. 04 datë 25. 02. 2010 ka vendosur të sekuestrojë pasuritë e mëposhtme:

- 1- **Pasuria truall + ndërtesë, me sipërfaqje totale xxx mx, e regjistruar me nr. x/xxx, Vol xx, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, lagja “xxxx xxxxx”-xxxxxx. Kjo pasuri i eshte blere shtetasit D. B., nga ana e shtetasit Sh. H. (babai i te pandehurit) ne daten 22/11/2000, sipas kontrates me nr. xxxxx Rep, xxx Kol, ne shumen 1 900 000 leke leke. Aktualisht ky objekt, pas vdekjes se te ndjerit Sh. H. (ne date 22/07/2003), sipas kontrates se shitblerjes me nr. xxxx Rep dhe xxx Kol, date xx/xx/xxxx, ka kaluar në bashkëpronësi të të pandehurit A. Sh. H. dhe vëllait të tij G. Sh. H. , te cilet kane paguar shumen prej 1 000 000 (njemilione) leke) leke.**
- 2- **Apartament “A”, me sipërfaqe xxx.xx mx, kati i xxxxx, i përbërë nga xxx dhoma xxx guzhinë, xx banjo, korridor, xx ballkone si dhe xxx garazh, te cilet ndodhen në kryqëzimin e rrugëve “xxxx xxxxx” dhe “xxxxxx xxxx”, Tiranë, regjistruar në pasurine me nr.x/xxx, zona kadastrale nr. xxxx, Regjistri xxx, Numri rendor xxx, datë xx.xx.xxxx, indeksi i hartes xx-x-xx, në pronësi të të pandehurit A. Sh. H.. Pasuri te cilat i pandehuri i ka blere, nga shtetasit E. M.i dhe S. H., sipas kontrates me nr.xxxx Rep dhe xxx Kol, ne shumen prej 4.500.000 (katermilione e peseqindemije) leke. Shume e cila eshte likujduar teresisht.**
- 3- **Pasuri me sipërfaqe totale xxx mx truall, dhe mbi këtë xxxxxx është ndërtuar një xxxxx “xxxxxxx” me sip.xxx mx , me vendodhje Zona**

*Kadastrale nr. xxxx, nr. i Pasurisë x/xxx, fleta nr.xxx indeksi, lagja "xxxxxxxx xxxxxxxx" -xxxxxx. Pasuri e cila eshte regjistruar ne emer te shtetasit G. Sh. H. dhe e ka blere nga seksioni i finances se keshillit te rrethit xxxxxxx, sipas kontrates me nr.xxxx Rep,xxx Kol, datë xx/xx/xxxx, në shumën 72 900 (shtetehjete e dymije e nënteqind) lekë.*

- 4- **Motorçiklete** xxxxxxxx, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, prodhim i vitit xxxx, me targa **xx xxx x**, në pronësi të të pandehurit **A. Sh. H.**, sipas kontrates me nr.xxxxx Rep, date xx/xx/xxxx, e blerë në shumën prej 110.000 lekë.*
- 5- Automjet Autoveturë, Marka xxxxxxxx-xxxxx, prodhim i vitit xxxx, me nr, shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, me targa **xx xx xx x** në pronësi të të pandehurit **A. Sh. H.**, blerë në vitin xxxx, sipas kontratës me nr. xxxxx Rregj, xxxx kol,*
- 6- Mjeti KAMION, marka xxxxx me nr. Shasie xxxxxxxx, prodhim i vitit xxxx, me targa **xx xx xx x**, në pronësi të shtetasit **G. Sh. H.**. Ky mjet është blerë nga shtetasi **G. H.**, më datë xx/xx/xxxx, sipas kontratës me nr.xxxx Rep dhe xxxx kol, në shumën 250.000 lekë.*
- 7- Mjeti AUTOVETURE, marka xxxx, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, prodhim i vitit xxxx, me targa **xx xx xx x**, në pronësi të shtetasit **T. Sh. H.**, sipas kontratës me nr. xxx, rep dhe xx kol, datë xx/xx/xxxx, i blerë në shumën prej 250.000 lekësh*
- 8- Llogari bankare pranë BKT – Lushnje, me nr. xx xx xx xxx, e celur në emër të të pandehurit A. Sh. H., në shumën 1, 148. 81 Euro.*

Këto prona të sekuestruara më pas janë administruar nga Administratorët e Agjensisë së Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Gjatë administrimit të pronave të konfiskuara administratorët kanë konstatuar se objekti "Pastiçeri" ndërtuar në sipërfaqen prej xxx m<sup>X</sup> ndodhur në lagjen "xxxxxxxx xxxxxxxx", xxxxxxx është shembur pasi objekti është ndërtuar në oborrin e një shkolle. Rrjedhimisht pjesë e kërkesës për konfiskim është vetëm trualli prej xxx m<sup>X</sup> i regjistruar në emër të shtetasit G. H..

Për shkak të kompleksitetit të çështjes gjykata ka vlerësuar se për sendet që janë sekuestruar kanë ruajtur të drejta jo vetëm personat që janë përmendur në vendimin për sekuestrim të sendeve, por edhe disa persona të tjerë. Në këtë mënyrë gjykata bazuar në nenin 22/3 të ligjit "Për parandalimin

dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” ka thirrur me cilësinë e personave të tretë shtetasit e përmendur më lart.

Më konkretisht gjykata e shkallës së parë “Për Krimet e Rënda” Tiranë me vendimin nr. 04 datë 25. 02. 2010 ka sekuestruar ndër të tjera një Apartament dhe një Garazh të cilët ndodhen në kryqëzimin e rrugëve “xxxx xxxxx” dhe “xxxxxx xxxxx”, Tiranë. Ky apartament i është sekuestruar në atë kohë të pandehurit A. H. Gjatë shqyrtimit të kërkesë për konfiskim në seancë gjyqësore rezultoi se i pandehuri A. H. më datë 21. 03. 2006 i ka shitur me kontratë noteriale shtetasit O. Sh. vetëm apartamentin e përmendur më lart në shumën 4 000 000 (katër milion) lekë. Shtetasi O. Sh. me pëlqimin edhe të bashkëshortes së tij K. Sh. më datë 28. 12. 2009 me kontratë noteriale i ka shitur të njëjtin apartament shtetasit S. G. në shumën shumën 23 000 000 (njëzet e tre milion) lekë.

Duke u nisur nga ky fakt gjykata thirri me cilësinë e personave të tretë në këtë proces shtetasit O. Sh , K. Sh. (bashkëshortë) dhe shtetasit S. G. dhe M. G. (bashkëshortë). Shtetasit e thirrur me cilësinë e personit të tretë në këtë gjykim, në kohë të ndryshme kanë qenë pronarë të xxxxxxxxx të sekuestruar më parë me vendim të gjykatës dhe për këtë shkak ata kishin interesa të drejtpërdrejta mbi sendin e sekuestruar. Si rrjedhim prania e tyre ishte e nevojshme në këtë gjykim.

Njëkohësisht gjatë procesit gjyqësor ka rezultuar se apartamenti me sipërfaqe xx m<sup>X</sup> që ndodhet në Lushnje për shkak të privatizimit të tij ka pasur si pronarë shtetasit Sh. H. ( i vdekur), M. H., L. H. , G. H. , A. H. , A. H. Këtë apartament shtetasit e përmendur më lart e kanë shitur më datë 24. 05. 2002 tek shtetasja F. H. Paratë e përfituara nga shitja e këtij apartamenti bashkëpronarët i kanë investuar në ndërtimi e godinës 5 katëshe në Lushnjë, godinë që është e sekuestruar me vendimin e gjykatës dhe që është objekt i konfiskimit. Për këtë shkak gjykata thirri me cilësinë e personave të tretë personat e përmendur më lart me përjashtim të të ndjerit Sh. H. i cili ka vdekur.

Njëkohësisht gjykata thirri me cilësinë e personave të tretë edhe bashkëshortët e shtetasve A. dhe G. H. që janë shtetas E. dhe D. H. pasi godina 5 kateshe e sekuestruar pronarëve A. dhe G. H. është fituar prej tyre gjatë periudhës së martesës.

Në fazën e shqyrtimit të kërkesës për konfiskim bazuar në nenin 21/3 të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit



nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” barra e provës për të provuar ligjshmërinë e fitimit të pronave të sekuestruara u takon personave që u janë sekuestruar këto prona. Në seancë gjyqësore personat që u ishin sekuestruar sendet paraqitën në gjykatë prova shkresore të cilat pasqyronin aktivitete e ligjshme të kryera prej tyre.

Mbrojtja paraqiti prova shkresore nga përmbajtja e të cilave gjykata konkludoi se një pjesë e sendeve të sekuestruara janë fituar në mënyrë të ligjshme nga personat të cilëve u janë sekuestruar këto sende.

**Apartamenti i banimit “x”** me sipërfaqë xxx, xx m<sup>x</sup> ndodhur në rrugën “xxxx xxxxx” Tiranë sekuestruar shtetasit A. H. ka rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se nuk është në pronësi të tij. Ky shtetas këtë apartament e ka shitur më datë 21. 03. 2006 tek personi i tretë O. Sh.. Pra që para vendosjes së sekuestros mbi këtë apartament, shtetasi A. H. nuk ka qenë më pronar i tij. Më pas personi i tretë O. Sh me pëlqimin e bashkëshortes së tij ja kanë shitur këtë apartament personit të tretë S. G.me kontratë noteriale më datë 28. 12. 2009.

Shtetasi A. H. apartamentin e banimit “x” me sipërfaqe xxx, xx m<sup>x</sup> së bashku me garazhin përkatës e ka blerë më datë 16. 09. 2003 nga shtetasit E. M. dhe S. H. në shumën prej 4 500 000 (katër milion e peëqindmijë) lekë. Më pas shtetasi A. H. apartamentin e banimit “A” ja ka shitur personit të tretë O. Sh. në shumën 4 000 000 (katër milion) lekë por pa garazhin përkatës. Aktualisht garazhi i sekuestruar vazhdon të mbetet në pronësi të shtetasit A. H.

Personi i tretë O. Sh. më datë 28. 12. 2009 ja kanë shitur apartamentin e banimit “x” personit të tretë S. G në shumën 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë. Personi i tretë O. Sh nuk ka pasur njohje të mëparshme me blerësin S. G. Njohja e këtyre personave është bërë rastësisht nëpërmjet një agjensie për shitblerjen e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu edhe i proceduari penalisht A. H nuk ka pasur njohje me personin e tretë O. Sh.

Bazuar në nenin 22/5 pika “a” dhe “b” të ligjit nr. 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” shitja e apartamentin të banimit në Tiranë nga i proceduari penalisht A. H. është kryer para afatit 2 vjeçar kur është regjistruar kërkesa fillestare për sekuestrimin e këtij sendi. Rrjedhimisht prokuroria bazuar në nenin 201/2 të Kodit të Procedurës Civile tërhoqi pjesërisht kërkesën për konfiskimin e këtij apartamenti.

**Pasuria truall + ndërtesë x xxxxx, me sipërfaqje totale xxx m<sup>x</sup>**, e regjistruar me nr. x/xxx, Vol xx, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, lagja “xxxx xxxxx”- xxxxxx rezultoi se është e regjistruar në pronësi shtetasve **A. Sh. H.** dhe vëllait të tij **G. Sh. H.** Fillimisht trualli mbi të cilin ekzistonte një ndërtesë një katëshe i është blerë shtetasit D. B. , nga ana e shtetasit Sh. H. (xxxx i te pandehurit) në datën 22/11/2000, sipas kontrates me nr. xxxx Rep, xxx Kol, në shumën 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë

. Aktualisht ky objekt është x katësh i ndërtuar mbi bazën e një leje ndërtimi të marrë nga KRT Lushnje. Pas vdekjes së të ndjerit Sh. H (në datë 22/07/2003), sipas kontratës së shitblerjes me nr.xxxx Rep dhe xxx Kol, datë 06/10/2003, ky objekt ka kaluar në bashkëpronësi të të proceduarit penalisht **A. Sh. H.** dhe vëllait të tij personit të tretë **G. Sh. H** , të cilët kanë paguar shumën prej 1 000 000 (një milion) lekë.

Për të vlerësuar godinën x katëshe dhe pajisjet që ndodhen në këtë godinë gjykata caktoi ekspertin vlerësues të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme E. G . Në variantet e vlerësimit të godinës x katëshe gjykata konsideron të drejtë variantin e fundit të paraqitur prej ekspertes. Ky variant vlerësimi i përgjigjet realitetit objektiv pasi ekspertja në këtë variant ka përcaktuar situacionin e punimeve duke zbritur zërin e shpenzimeve të transportit dhe të fitimit në dritare vetrata dhe duro alumin. Zbritja e këtyre zërave në situacionin e punimeve ka ndodhur për faktin se godina është ndërtuar personalisht nga familja H. Ata kanë qenë investitorët dhe ndërtuesit e kësaj godine. Vëllezërit G. dhe A. H në kohën e ndërtimit të godinës kanë qenë ortak të shoqërisë “xxx” shpk.

Shoqëria “xxx” shpk si objekt të veprimtarisë së saj ekonomike ka pasur ndër të tjera prodhimin e dyerve, dritareve vetrata dhe duro alumin si dhe transportimin e mallrave të ndryshme. Rrjedhimsht në përcaktimin e vlerës së godinës në këtë variant ekspertja ka zbritur fitimin që shoqëria do të realizonte në shitjen e dyerve dhe dritareve si dhe transportin e të gjitha materiale që kanë shërbyer për ndërtimin e godinës. Sipas këtij vlerësimi ka rezultuar se godina 5 katëshe ka një vlerë prej 11 622 337 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

Pajisjet e tjera të gjetura në godinë nga ekspertja janë vlerësuar në shumën 3 659 600 (tremilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë.

Pronarët e godinës 5 katëshe dhe personat e tretë të famijes H. në

procesin gjyqësor kanë paraqitur prova shkresore për të provuar ligjshmërinë e ndërtimit dhe zotërimit të godinës x katëshe me pajisjet e gjetura brenda saj. Konkretisht familja H. paraqiti në gjykatë një kontratë të privatizimit të një apartamenti datë 30. 09. 1993 mbi bazën e së cilës familja H. është bërë pronare e një apartamenti x + x me sipërfaqe xx m<sup>x</sup> që ndodhet në lagjen “xxxxx xxxxxxxx” në Lushnje.

Mbi bazën e kontratës së shitblerjes datë 24. 05. 2002 familja H. ja ka shitur këtë apartament shtetasës F. H në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Në seancë gjyqësore mbrojtja paraqiti një deklaratë noteriale nga blerësja F. H me nr. xxxx Rep. dhe nr. xx xxx kol. datë 13. 10. 2010 sipas së cilës rezultoi se blerësja nuk ka paguar shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë që është shënuar gabimisht në kontratë por shumën 5 000 000 (pesëmilion) lekë. Sipas mbrojtjes kjo shumë parash ka shërbyer si vlerë për investim në ndërtimin e godinës x katëshe. Përveç kësaj shume mbrojtja paraqiti dokumenta që përfaqësonin bilancet vjetore të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë “xxx” shpk si dhe librat e xhirove të biznesit të vogël që kanë pasur personat e tretë T. H dhe A. H.

Kryesisht mbi bazën e këtyre veprimtarive ekonomike si dhe të ardhurave që shtetasit A. dhe G. H. kanë realizuar në Greqi mbrojtja konkludoi se se pasuritë e sekuestruar me vendimin e gjykatës janë fituar nëpërmjet një veprimtarie të ligjshme ekonomike.

Gjykata nuk e vlerësoi si provë deklaratën noteriale të sjellë nga mbrojtja por konstatoi se vlera prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh nuk përfaqëson vlerën reale të apartamentit të shitur nga familja H. në vitin 2002. Për këtë shkak gjykata i kërkoi ekspertës vlerësuese të pasurive të paluajtshme E. G. të vlerësoi apartamentin me vlerën e tregut që ai kishte në vitin 2002. Sipas aktit të ekspertimit vlerësues rezultoi se vlera e apartamentit x + x me sipërfaqe xx m<sup>x</sup> që ndodhet në lagjen “xxxxxx xxxxxx” në xxxxx në vitin 2002 ka qenë 3 778 880 (tre milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë. Pikërisht kjo shumë përfaqëson një pjesë të fitimit që familja H. ka siguruar nga shitja e apartamentit.

**Për pasurinë truall + ndërtesë x katëshe, me sipërfaqje totale xxx m<sup>x</sup>,** e regjistruar me nr. x/xxx, Vol xx, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxxx, lagja “xxxx xxxxxx”- xxxxxxxx në pronësi shtetasve A. Sh. H. dhe vëllait të tij G. Sh. H, ashtu si kundër edhe për apartamentin “A” që ndodhet në Tiranë, prokuroria bazuar në nenin 201/2 të Kodit të Procedurës Civile si dhe në nenin 24 të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

tërhoqi kërkesën për konfiskim dhe i kërkoi gjykatës që të heq masën e sekuestrimit të vendosur më parë.

Për pjesët e tjera të pasurive të sekuestruara që janë **një garazh** që është në apartamentin e ndodhur në rrugën Nikolla Tupe në Tiranë, **sipërfaqe trualli xxx mx truall**, me vendodhje lagja “xxxxx xxxxxx” – xxxxxxxx, **Motorçiklete xxxxxxxx**, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx me targa **xx xxx x**, automjet autoveturë, **xxxxxxxxxxxxxxxx** - **xxxxxx**, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, me targa **xx xx xx x**, KAMION, marka **xxxxxxx** me nr. Shasie xxxxx me targa **xx xx xx x**, autoveturë xxxx, me nr. shasie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, me targa **xx xx xx x**, Llogari bankare pranë BKT – Lushnje, me nr. xx xx xx xxx, e çelur në emër të të pandehurit **A. Sh. H.**, në **shumën 1, 148. 81 Euro**, prokuroria kërkoi konfiskimin e tyre.

Gjykata vlerësoi se të ardhurat nga viti 1993 – 2006 për familjen H. që janë pjesëmarrës në këtë proces janë të përfituara nga këto burime:

- Fitime që rrjedhin nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë “xxx” shpk nga viti 1999 deri në 2006.
- Të ardhura të realizuara nga biznesi i vogël i personit të tretë T. H që është “Salle lojrash e bufe”.
- Të ardhura të realizuara nga biznesi i vogël i personit të tretë A. H. (V ) që është “xxxxx”.
- Fitimi i realizuar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe xx m<sup>x</sup> ndodhur në lagjen xxxxxx xxxxxxxx në xxxxxx.
- Ndihma ekonomike për personin e tretë A. H. bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje.
- Pension pleqërie për personin e tretë M. H. bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje.
- Pension pleqërie për të ndjerin Sh. H. deri në vitin 2003 bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje.

Gjykata nuk e vlerësoi si burim të ardhurash deklaratën e përgjegjesisë datë 28. 09. 2010 të bërë nga shtetasi grek E. K. nga përmbajtja e së cilës rezultoi se vëllezërit G. dhe A. H. kanë qenë të punësuar tek ky person në shtetin grek nga data 01. 01. 1993 deri më datë 31. 12. 1995 dhe që janë paguar me një shumë prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetëmijë) dhrahmi në muaj. Kjo deklaratë nuk u shoqërua në gjykim me ndonjë provë tjetër për të provuar faktin se shtetasit G. dhe A. H. kanë jetuar në Greqi nga viti 1993 deri në vitin 1995.

Për të vlerësuar të ardhurat që ka siguruar familja H. nga

veprimtaritë e saj ekonomike gjykata caktoi ekspertin kontabël L. Ç. (H.). Në aktin e ekspertimit kontabël ekspertja paraqiti dy variante të të ardhurave që ka realizuar familja H.. Gjykata, ashtu sikurse edhe prokuroria, merr në konsideratë variantin e dytë të hartuar prej ekspertes. Në këtë variant ekspertja ka llogaritur të ardhurat e realizuara nga bizneset e vogla që administroheshin nga personat e tretë T. H dhe A. H (V.). Të ardhurat e realizuara nga bizneset e vogla janë llogaritur mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga librat e blerjeve të cilat kanë qenë administruar më parë nga organet tatimore në Lushnje. Duke u mbështetur në këtë variant të ardhurat e familjes H. rezultojnë si më poshtë:

- Fitime që rrjedhin nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë “xxx” shpk nga viti 1999 deri në 2006 që janë **12 976 915 lekë.**
- Të ardhura të realizuara nga biznesi i vogël i personit të tretë T. H. që është “xxxxx xxxxxx e xxxx” që janë **4 621 531 lekë.**
- Të ardhura të realizuara nga biznesi i vogël i personit të tretë A. H. (V.) që është “xxxxxxx” që janë **2 028 197 lekë.**
- Fitimi i realizuar nga xxxxx e apartamentit me sipërfaqe xx m<sup>x</sup> ndodhur në lagjen xxxxxx xxxxxxxx në xxxxxx vlerësuar nga ekspertja me vlerën e tregut që ka pasur apartamenti në kohën e shitjes **3 778 880 lekë.**
- Ndihma ekonomike për personin e tretë A. H. bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje **940 200 lekë.**
- Pension pleqërie për personin e tretë M. H. bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje **470 843 lekë.**
- Pension pleqërie për të ndjerin Sh. H. deri në vitin 2003 bazuar në vërtetimin e lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Lushnje **528 550 lekë.**

Në total familja H. ka realizuar një fitim prej **25 345 116 ( njëzet e pesë milion e treqindedyzetepesë mijë e njëqindegjashtëmbëdhjetë) lekë.**

Gjykata i kërkoi ekspertës të llogarisë shpenzimet minimale për frymë të familjes H. nga viti 1993 – 2006. Shpenzimet minimale për frymë ekspertja i ka llogaritur duke u mbështetur në një vërtetim të sjellë nga INSTAT e cila ka evidentuar shpenzimet minimale për një person në vitin 2002 dhe në vitin 2005. Mbi bazën e këtyre të dhënave ekspertja ka llogaritur shpenzimet minimale të familjes H. që përbëhej prej xx personash deri në mesin e vitit 2003 dhe më pas kjo familje është reduktuar në x persona për shkak të vdekjes së të ndjerit Sh. H.

Në bazë të aktit të ekspertimit shpenzimet minimale të familjes H. nga viti 1993 – 2006 arrin në shumën **8 093 754 (tetëmilion e nëntëdhjetëetremijë e shtatëqindpesëdhjetë katër) lekë.**

Njëkohësisht gjykata i kërkoi ekspertës kontabël që të përcaktojë vlerën e e të gjitha sendeve të sekuestruar nga gjykata. Sendet e sekuestruara përfshijën pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme (mjete monetare dhe mjete motorike). Sipas përlllogaritjes së bërë nga ekspertja në aktin e ekspertimit sendet e sekuestruar vlerësohen si më poshtë:

– Truall dhe ndërtesë me sip. xxx m <sup>x</sup>	1 000 000 lekë
– Apartament “X” me sip. xxx, xx m <sup>x</sup>	4 500 000 lekë
– Truall me sip. Xxx m <sup>x</sup>	72, 900 lekë
– Motorcikletë xxxxxxxx me targë xx xxx x	110 000 lekë
– Automjet MITSUBISHI	s’ ka vlerë
– Kamion SAURER me targa xx xxxx x	250 000 lekë
– Autoveturë BENZ me targa xx xxxx x	250 000 lekë
– Llogari bankare BKT Lushnje xxxx, xx euro	143 601 lekë
– Banesa x katëshe Lushnje sipas aktit të ekspertimit të ekspertës vlerësuese	11 622 337 lekë
– Pajisjet e gjetura në godinën x katëshe Lushnje sipas aktit të ekspertimit vlerësues	3 659 600 lekë
– <b>Totali i vlerës së objekteve të sekuestruara</b>	<b>21 608 438 lekë</b>

Në seancë gjyqësore mbrojtja paraqiti disa kontrata shitblerje mb bazën e të cilave rezultoi se mjetet motorike MITSUBISHI, Motorcikleta YAMAHA, Kamioni SAURER, Autoveturë BENZ janë transferuar tek persona të tjerë Gjykata gjatë procesit gjyqësor i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (D. P. Sh. T. Rr) të dhëna që lidhen me pronësinë e mjeteve motorike të përmendura më lart. D. P. Sh. T. Rr me shkresën nr. 7751/1 prot. datë 09. 11. 2010 konfirmon faktin se mjete motorike të përmendura më lart figurojnë të regjistruar në emër të shtetasve A. H., G. H. dhe T. H. që janë palë në këtë proces gjyqësor. Kjo do të thotë se lejet e qarkullimit të mjeteve motorike të përmendura më lart vazhdojnë të jenë në emër të personave që janë palë në këtë gjykim. Si rrjedhim personat e tretë vazhdojnë të figurojnë pronarë të mjeteve motorike të sekuestruara.

Për të përcaktuar prejardhjen e ligjshme të sendeve të sekuestruara gjykata do të krahasojë fitmin që ka realizuar familja H. nga viti 1993 deri në vitin 2006 me shpenzimet që ka kryer kjo familje për këtë periudhë kohe.

Në zërin e shpenzimeve gjykata përfshin shpenzimet minimale të familjes H. së bashku me shpenzimet që ka kryer kjo familje në blerjen dhe ndërtimin e sendeve të sekuestruara.

Sipas aktit të ekspertimit kontabël vlera e sendeve të sekuestruara është xx xxx xxx lekë. Kjo vlerë nuk përfaqëson shpenzimet reale që ka kryer familja H. për sendet e sekuestruara. Në vlerën e sendeve të sekuestruara ekspertja ka përfshirë edhe shumën e gjetur në llogarinë bankare BKT Lushnje që është 1148, 81 euro. Kjo shumë e sekuestruar nuk është një shpenzim por përfaqëson një depozitë bankare që rrjedh nga një aktivitet që mund të jetë i ligjshëm apo i paligjshëm. Gjithashtu në vlerën e sendeve të sekuestruara ekspertja ka vlerësuar në shumën 4 500 000 lekë apartamentin “x” me sip. xxx, xx m<sup>x</sup> që shtetasi A. H e ka blerë në Tiranë. Nga gjykimi ka rezultuar se shtetasi A .H ja ka shitur këtë apartament në shumën 4 000 000 lekë personit të tretë O . Sh .

Rrjedhimisht shpenzimit në shumën 4 500 000 lekë që shtetasi A. H. ka bërë për blerjen e apartamentit duhet ti zbritet e ardhura në shumën 4 000 000 lekë që ky shtetas ka përfituar nga shitja e apartamentit. Kështu që gjykata përfshin në zërin e shpenzimeve shumën prej 500 000 (pesëqind mijë) lekë që është diferenca e çmimit të blerjes dhe shitjes së apartamentit “x” me sip. xxx, xx m<sup>x</sup> në Tiranë nga shtetasi A. H.

Nga kjo përlllogaritje rezulton se shpenzimet e familjes H. për blerjen e pasurive të sekuestruar arrijnë shumën e **17 464 837 (shtatëmbëdhjetë**

**milion e katërqindegjashtëdhjetëkatër mijë e tetëqindetridhjetëeshtatë) lekë.** Shpenzimet për blerjen e pasurive të sekuestruara do të shtohen edhe shpenzimet minimale të konsumit që janë 8 093 754 lekë dhe në përfundim rezulton se shpenzimet e përgjithshme të familjes H. janë **25 558 591 (njëzetepesë milion e pesëqindpesëdhjetëetë mijë e pesëqindënëntëdhjetëenjë) lekë.**

Siç e përmendëm më lart, për vitet 1993 – 2006 të ardhurat e përgjithshme të familjes H. janë **25 345 116** (njëzet e pesë milion e treqindedyzetepesë mijë e njëqindegjashtëmbëdhjetë) lekë dhe shpenzimet e përgjithshme të kësaj familje janë **25 558 591** (njëzetepesë milion e pesëqindpesëdhjetëetë mijë e pesëqindënëntëdhjetëenjë) lekë. Nga krahasimi i i të dy zërave rezulton se shpenzimet e familjes H. janë më të mëdha se të ardhurat e siguruara. Diferenca ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave është **213 475 (dyqindetrembëdhjetë mijë e katërqindeshtatëdhjetëepesë) lekë.**

Shuma prej **213 475** (dyqindetrembëdhjetë mijë e katërqindeshtatëdhjetëepesë) lekësh nuk përlligjet me të ardhurat e fituara nga familja H. dhe si e tillë në bazë të nenit 24/1/b të ligjit nr. 10192 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” pasuritë e sekuestruara që i përgjigjen në vlerë shumë prej **213 475 lekësh** do të konfiskohen. Shumës prej **213 475 lekësh** i korrespondojnë llogaria bankare prej xxxx, xxx xxxx e konvertuar në 143 601 lekë dhe trualli me sip. xxx m<sup>x</sup> që ndodhet në qytetin e Lushnjes i vlerësuar me 72 900 lekë.

Në përfundim gjykata konfiskon truallin prej xxx m<sup>x</sup> që ndodhet në qytetin e Lushnjes regjistruar në emër të personit të tretë G. H. dhe shumë prej 1148, 81 euro që ndodhet në llogarinë bankare pranë BKT Lushnje në emër të shtetasit A. H. Pasuritë e tjera të sekuestruara më parë me vendimin e gjykatës nr. 04 datë 25. 02. 2010 do të kthehen personave që ju janë sekuestruar duke hequr edhe masën e sekuestros që është vendosur më parë.

Në arritjen e këtij përfundimi gjykata nuk e mbështet kërkesën e prokurorisë për konfiskimin edhe të të gjitha mjeteve motorike si dhe të garazhit që figuron i regjistruar në emër të të proceduarit penalisht A. H. Fillimisht prokuroria në përlllogaritjen e fitimeve të siguruara nga familja H. është ndalur edhe në fitimet e siguruara nga shoqëria “xxx” shpk që ka për ortak shtetasit A. H. dhe G. H. Prokuroria ka arritur në përfundimin se shoqëria “xxx” shpk gjatë periudhës kohore 1999 – 2006 ka akumuluar një fitim në shumë 12 976 915 lekë mbështetur në aktin e ekspertimit kontabël. Ky përfundim është i njëjtë me përfundimin e konkluduar nga gjykata që u përmend



më lart. Në vijim prokuroria ka theksuar se fitimit të akumuluar nga shoqëria “xxx” duhet ti zbritet 10% për shkak se bazuar në nenin 33 të ligjit 8438 datë 28. 12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” personi që tërheq fitimet e shoqërisë duhet të paguajë tatim mbi dividendin në masën 10%. Kështu që prokuroria ka llogaritur se të ardhurat e shoqërisë pakësohen në vlerën  $1\,297\,961 - (10\%) \cdot 1\,297\,961 = 1\,167\,924$ .

Gjykata vlerëson se përfundimi i mësipërm nuk është i mbështetur në ligjin nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”. Objekti i gjykimit në gjykatën “Për Krimet e Rënda” referuar ligjit të përmendur më lart është verifikueshmëria e ligjshmërisë së sendeve të sekuestruara personave që dyshohet se kanë lidhje me veprimtaritë kriminale të parashikuar nga neni 3 i këtij ligji. Kjo dispozitë parashikon edhe fushën e zbatimit të këtij ligji.

Në rastin konkret mospagimi i pjesës 10% të fitimit tek organet tatimore nga ortakët e shoqërisë “xxx” për shkak të dividendit të marrë prej tyre në fund të vitit, nuk mund ti shndërrojë këta persona si subjekte të ndëshkueshëm nga ligji “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”. Mospagimi i tatimit 10% mbi dividendin passjell marrjen e masave me karakter administrativ të cilat vlerësohen dhe vendosen nga organet tatimore. Në rastin në gjykim nuk rezultoi se shoqëria “xxx” shpk apo ortakët e saj që janë shtetasit A. H. dhe G. H. , palë në këtë proces gjyqësor të jenë debitor në organet tatimore. Rrjedhimisht përfundimi i nxjerrë nga prokuroria nuk është i mbështetur në ligj.

Në konkluzionet e paraqitura me shkrim prokuroria ka kërkuar heqjen dorë pjesërisht nga e drejta e padisë, pushimin e gjykimit dhe revokimin e masës së sekuestros për pasuritë apartament banimi “x” me sip. xxx, xx m<sup>x</sup>, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe xxx m<sup>x</sup>. Meqënëse në konkluzionet me shkrim prokuroria ka konfunduar pasojën e heqjes dorë nga e drejta e padisë dhe heqjes dorë nga e drejta e gjykimit, në seancë gjyqësore prokurori në mënyrë të qartë sqaroi se organi i akuzës ka hequr pjesërisht dorë nga e drejta e padisë (kërkimit) për konfiskim të pasurive të përmendura më lart duke i kërkuar gjykatës që ajo ta rrëzojë kërkesën për konfiskim vetëm për apartamentin e banimit “x” me sip. xxx, xx m<sup>x</sup> dhe truallin + ndërtesë me sipërfaqe xxx m<sup>x</sup>.

Kështu që për arsyet e përmendura më lart gjykata pranon pjesërisht kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e sendeve të sekuestruara.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenet 22, 23, 24, 28 – 38 të ligjit nr. 10192 datë 03.12. 2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe duke u bazuar në nenin 201/2 të Kodit të Procedurës Civile

## V E N D O S I

- **Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:**

1. **Pasurisë me sipërfaqe totale xxx m<sup>X</sup> truall**, me vendodhje Zona Kadastrale nr. xxxx, nr. i Pasurisë x/xxx, fleta nr. xxxx indeksi, lagja “xxxxxx xxxxxxxx” - Lushnje e cila është regjistruar në emër të shtetasit **G. Sh. H.** dhe e ka blerë nga seksioni i financës së Këshillit të rrethit Lushnje, sipas kontratës me nr. xxxx Rep, xxx Kol, datë xx/xx/xxxx.
2. **Llogarisë bankare pranë BKT – Lushnjë**, me nr. xx xx xx xxx, e çelur në emër të të shtetasit **A. Sh. H.**, në shumën **1 148, 81(një mijë e njëqind e dyzet e tetë presje tetëdhjetë e një) Euro**.

- **Rrëzimin e kërkesës për konfiskim dhe heqjen e sekuestros për pasuritë e mëposhtme:**

1. **Truall + ndërtesë, me sipërfaqje totale xxx m<sup>X</sup>**, e regjistruar me nr. x/xxx, Vol xx, faqe xxx, Zona Kadastrale nr. xxxx, lagja “xxxx xxxx”-Lushnjë. Ky objekt, sipas kontratës së shitblerjes me nr. xxxx Rep dhe xxx Kol, datë xx/xx/xxxx, ka kaluar në bashkëpronësi të shtetasit **A. Sh. H.** dhe vëllait të tij shtetasit **G. Sh. H.**
2. **Apartament banimi “A”, me sipërfaqe xxx. xx m<sup>X</sup>**, kati i xxxxx, i përbërë nga xxx dhoma xxx guzhinë, xx banjo, korridor, xx ballkone i cili ndodhet në kryqëzimin e rrugëve “xxx xxxxx” dhe “xxxxxx xxxx” Tiranë, regjistruar në pasurinë me nr. x/xxx, zona kadastrale nr. xxxx, Regjistri xxx, Numri rendor xxx, datë xx. xx. xxxx, indeksi i hartes xx-x-xx, fillimisht në pronësi të shtetasit **A. Sh. H.** dhe më pas kaluar në pronësi të personave të tretë **O. Sh.** dhe në fund personit të tretë **S. G.**
3. **Një garazh**, e cila ndodhet në kryqëzimin e rrugëve “xxxx xxxx” dhe “xxxxxx xxxx” Tiranë, regjistruar në pasurinë me nr. x/xxx, zona

kadastrale nr. xxxx, Regjistri xxx, numri rendor xxx, datë xx. xx. xxxx, indeksi i hartes xxx-x-xx, në pronësi të shtetasit **A. Sh. H.**

- 4 **Motorçikletë** **xxxxxxxx**, me nr. shasie **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, prodhim i vitit xxxx, me targa **xx xxx x**, në pronësi të shtetasit **A. Sh. H.**, e blerë në datë xx/xx/xxxx, sipas kontratës me nr. xxxx Repertori.
- 5 Automjetit tip Autoveture, Marka **xxxxxxxx** - **xxxxx**, prodhim i vitit **xxxxx** me nr, shasie **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, me targa **xx xx xx x** në pronësi të shtetasit **A. Sh. H.**, blerë në vitin **xxxxx**, sipas kontratës me nr. **xxxxxx** Rep/xxxxx Kol.
- 6 Mjetit KAMION, marka **xxxxxxxx** me nr. Shasie **xxxxxx**, prodhim i vitit **xxxxx**, me targa **xx xx xx x**, në pronësi të shtetasit **G. Sh. H.** Ky mjet është blerë nga shtetasi G. H. , më datë xx/xx/xxxx, sipas kontratës me nr. **Xxxx** Rep dhe **xxxx** kol.
- 7 Mjeti AUTOVETURE, marka **xxxx**, me nr. shasie **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, prodhim i vitit **xxxxx**, me targa **xx xx xx x**, në pronësi të shtetasit **T. Sh. H.**, sipas kontratës me nr. **xxx**, rep dhe **xx** kol, datë xx/xx/xxxx.

Ngarkohen zyrat e përmbarimit të rretheve Tiranë dhe Lushnje të ekzekutojnë këtë vendim.

Ngarkohet administratorja **E. Ç.** në Agjensinë për Administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara në Ministrinë e Financave Tiranë *të administrojë pasurinë e paluajtshme* të konfiskuar më lart.

Ngarkohet administratori **I. D.** në Agjensinë për Administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara në Ministrinë e Financave Tiranë *të administrojë pasuritë e luajtshme* të konfiskuar më lart.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit “Për Krimet e Rënda” Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij.

***U shpall më datë 16. 05. 2011.***

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**EVLOINDA ADILI**

**KLODIAN KURUSHI**